

PRISHTINË, TETOR 2020

# TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

# 2

## Menaxhimi i financave





# TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

Menaxhimi i financave

Prishtinë, tetor 2020

**Publikues:**

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

[www.orca-ks.org](http://www.orca-ks.org)

[info@orca-ks.org](mailto:info@orca-ks.org)

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Prishtina, 10000, Kosova

**Hulumtues dhe autorë:**

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

**Design:**

Envinion



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë  
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.  
Falna durimin të thellojmë një punë përpara  
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një  
ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo  
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!  
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga  
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e  
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

# TABELA E PËRMBAJTJES

Listë e shkurtesave .....	9
Hyrje.....	10
Metodologjia .....	11
Gjetjet kryesore.....	12
<b>Universiteti i Prishtinës.....</b>	<b>18</b>
Analiza e shpenzimeve .....	20
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës .....	21
Analiza e të dhënave nga deklaratat e pasurisë.....	23
<b>Universiteti i Prizrenit .....</b>	<b>26</b>
Analiza e shpenzimeve .....	27
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit .....	28
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë .....	29
<b>Universiteti i Pejëës.....</b>	<b>32</b>
Analiza e shpenzimeve .....	33
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejëës.....	35

Analiza e të dhënave nga deklaratat e pasurisë.....	36
<b>Universiteti i Gjakovës .....</b>	<b>40</b>
Analiza e shpenzimeve .....	40
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës .....	41
Analiza e të dhënave nga deklaratat e pasurisë.....	43
<b>Universiteti i Mitrovicës.....</b>	<b>46</b>
Analiza e shpenzimeve .....	46
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës .....	48
Analiza e të dhënave nga deklaratat e pasurisë.....	50
<b>Universiteti i Gjilanit.....</b>	<b>52</b>
Analiza e shpenzimeve .....	53
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit .....	54
Analiza e të dhënave nga deklaratat e pasurisë.....	55
<b>Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.....</b>	<b>58</b>
Analiza e shpenzimeve .....	58
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj .....	60
Analiza e të dhënave nga deklaratat e pasurisë.....	61
<b>ANEKSET .....</b>	<b>64</b>





# LISTË E SHKURTESAVE

- **MASH** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- **PSAK** - Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
- **UP** - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
- **UHZ** - Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
- **UPZ** - Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
- **UGJFA** - Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
- **UMIB** - Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
- **UKZ** - Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
- **USHAF** - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- **AKK** - Agjencia Kundër Korrupsion
- **ASK** - Agjencia e Kosovës për Statistika
- **ZKA** - Zyra Kombëtare e Auditimit
- **KEEN** - Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
- **ORCA** - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

# HYRJE

Fondet publike vazhdojnë ta përbëjnë burimin kryesor të financimit për universitetet publike, prandaj transparenca dhe llogaridhënia e këtyre institucioneve është e domosdoshme.

Marrë për bazë rëndësinë e menaxhimit të financave, ORCA ka vendosur të vazhdojë me hulumtimin, analizimin dhe krahasimin e shpenzimeve të universiteteve publike, me theks të veçantë tek stafi akademik menaxherial.

Të dhënat në këtë raport janë marrë nga raportet vjetore të buxhetit të universiteteve publike, komunikimi përmes adresës elektronike me universitete, raporti vjetor financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019<sup>1</sup>, raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për vitin 2019, raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin 2019, deklaratimet e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, si dhe nga Agjencia e Kosovës për Statistika.

Pjesë e këtij hulumtimi janë stafi akademik i universiteteve publike me këto pozita menaxheriale: anëtar i Këshillit Drejtues, rektor, prorektor, dekan dhe prodekan.

Qëllimi i hulumtimit është të gjejë/sjellë informata rreth pagave bazë me të cilat paguhen këta zyrtarë sipas rregulloreve për të ardhura personale dhe mëditjeve apo shtesave që marrin.

Krahasuar me raportin e vitit 2018<sup>2</sup> dhe atë me planifikime për vitin 2019<sup>3</sup>, të hulumtuara nga ORCA, rezulton se ka përmirësime të dukshme sa i përket shumës së shtesave të cilat i marrin stafi akademik menaxherial, pra me rritjen e transparencës kanë filluar të bien edhe shtesat e tyre.

<sup>1</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

<sup>2</sup> Raporti "Borgjezia e Akademisë", 2019, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Borgjezia-e-Akademis%C3%AB-1.pdf>

<sup>3</sup> Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës-Menaxhimi i Financave" 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/01-Shpenzimet-e-universiteteve-publike-ALB-01.pdf>

# METODOLOGJIA

Në këtë raport është bërë krahasimi i shpenzimeve të vitit 2018 me vitin 2019, si dhe planifikimet buxhetore për vitin 2020 në shtatë universitetet publike (Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjilanit, dhe Universiteti i Ferizajt).

Raporti përmban informata të detajuara rreth pagave dhe mëditjeve të stafit akademik menaxherial nga të gjitha universitetet publike, shpenzimeve për bursa të studentëve, për investime kapitale, fondin për shkencë, sigurimin fizik të objekteve dhe shpenzimeve gjyqësore.

Deklarimet e pasurisë të vitit 2019 të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike në Kosovë janë të publikuara në uebfaqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.<sup>4</sup> Në këto deklarime stafi akademik menaxherial deklaron të ardhurat e tyre vjetore nga buxheti i universitetit/qeverisë. Këto të ardhura vjetore janë pjesëtuar për muaj, dhe nga shumat mujore janë zbritur paga bazë e caktuar sipas rregulloreve respektive për të ardhura personale të universiteteve. Pjesa e mbetur janë shtesa të dhëna nga universitetet për shërbime të ndryshme, si: shtesa për pozita menaxheriale (rektor, pro-rektor, dekan, pro-dekan, këshill drejtues, etj.), shtesat për mbi-norma (orë shtesë/honorare), si dhe shtesat për mentorime të temave të diplomës Bachelor (BA), Master (MA) dhe doktoratë (PhD).

Shtatë universitetet publike janë kontaktuar përmes adresës elektronike, përmes të cilës u janë kërkuar të dhëna të cilat nuk gjendeshin të publikuara në faqet zyrtare elektronike të universiteteve. Me infomatat e kërkuara, kërkesës së ORCA-s i janë përgjigjur Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjakovës dhe Universiteti i Ferizajt, kurse Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Mitrovicës nuk kanë kthyer përgjigje.

ORCA ka kontaktuar edhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, ku u janë kërkuar raportet e auditimit të brendshëm për universitetet publike për vitin 2019 dhe raportet financiare të shpenzimeve të universiteteve publike për vitin 2019, kërkesa të cilat janë injoruar nga zyrtarët kompetentë, pavarësisht Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Memorandumit për Bashkëpunim.

<sup>4</sup> Deklarimi i pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, 2020, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, linku: [https://akk-ks.org/deklarimi\\_i\\_pasurisë/1805/Ministria\\_e\\_Arsimit\\_Shkencës\\_dhe\\_Teknologjisë/1805/](https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasurisë/1805/Ministria_e_Arsimit_Shkencës_dhe_Teknologjisë/1805/)

# GJETJET KRYESORE

Numri i përgjithshëm i personelit akademik të rregullt në universitete publike, është 1 mijë e 275 (685 gra dhe 590 burra), ndërsa i të angazhuarve, është 700 (356 gra dhe 344 burra)<sup>5</sup>.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në nivelin Bachelor nga të gjitha universitetet publike, është 50 mijë e 91 studentë. Ndërkaq numri i studentëve të diplomuar (2019/2020), është 7 mijë e 282.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në nivelin Master është 8 mijë e 184. Ndërkohë që numri i studentëve të diplomuar në këtë nivel (2019/2020), është 2 mijë e 274.

Raporti student-mësimdhënës në nivel të universiteteve publike del të jetë 45:1.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar Raportin e Auditimit për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019<sup>6</sup>. Ky auditim është bazuar në analizimin e pasqyrave financiare vjetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe zbatimin e rekomandimeve.

Në Raportin e Auditimit për MASHT-in për vitin 2019, është gjetur se katër nga gjashtë universitetet publike me aprovime të këshillave drejtuese kishin përfshirë në rregullore, kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa lloje të komisioneve që konsiderohen si jostatutare.

Ndërkaq sipas këtij raporti, Ligji për menaxhimin e financave publike<sup>7</sup> nuk lejon kompensimin shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose autoritet tjetër publik. Meqenëse shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi.

5 Raporti "Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20" i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, linku: [https://ask.rks-gov.net/media/5460/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB\\_2019-20\\_gjuheshqipe.pdf](https://ask.rks-gov.net/media/5460/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB_2019-20_gjuheshqipe.pdf)

6 "Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019", linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-auditimit-MASHT-2019-Shqip.pdf>

7 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, 2008, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

Katër nga gjashtë universitetet në kuadër të MASHT-it, me aprovime të këshillave drejtuese kishin përfshirë në rregullore kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa komisione. Bëhet fjalë për Universitetin e Prizrenit me shumë prej 27,650 Euro, Universitetin e Gjakovës me vlerë prej 2,845 Euro, Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me shumë prej 3,010 Euro, si dhe Universiteti i Gjilanit me shumë prej 9,245 Euro.

E gjetur tjetër në Raportin e Auditimit për Universitetin e Prishtinës për vitin 2019 janë edhe 79 profesorët e Universitetit të Prishtinës të cilët janë angazhuar me punë sekondare në universitete tjera publike për të cilat nuk kishin marrë miratimin paraprak nga rektori i UP-së.

Madje një prej këtyre profesorëve që ligjëron në Fakultetin e Filologjisë në UP, ishte i angazhuar me kontratë edhe në dy institucione të tjera, për të njëjtën periudhë kohore. Njëra kontratë ishte si profesor i rregullt në një kolegji privat dhe kontrata tjetër për honorar në Universitetin e Prizrenit.


“Angazhimet e profesorëve për punë shtesë pa miratimin e menaxhmentit, përveç se është në kundërshtim me kërkesat e rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, ndikon në cilësinë e procesit arsimor për shkak të angazhimeve të shumta të personelit akademik”, thuhet në raport, ndërkohë që është rekomanduar rishikimi i rasteve të identifikuara dhe marrja e masave përkatëse ndaj personelit i cili nuk i zbaton rregulloret.

Në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë për vitin 2017-2021<sup>8</sup>(PSAK), për arsimin e lartë janë ndarë 3 milionë e 648 mijë euro për vitin 2019, 5 milionë e 99 mijë euro për vitin 2020, ndërkaq në vitin 2021, janë planifikuar të shpenzohen 7 milionë e 357 mijë euro, pra gjithsej 22 milionë e 232 mijë euro.

Sa i përket kategorive ekonomike, vetëm në paga dhe mëditje janë



Në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë për vitin 2017-2021(PSAK), për arsimin e lartë janë ndarë 3 milionë e 648 mijë euro për vitin 2019, 5 milionë e 99 mijë euro për vitin 2020, ndërkaq në vitin 2021, janë planifikuar të shpenzohen 7 milionë e 357 mijë euro, pra gjithsej 22 milionë e 232 mijë euro.



<sup>8</sup> Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, 2016, linku: [https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf)


planifikuar të shpenzohen 9 milionë e 478 mijë euro, ndërsa për subvencione dhe transfere, janë paraparë të shpenzohen 7 milionë e 600 mijë euro. Për arsimin e lartë, MASHT-i ndanë 7 milionë e 636 mijë euro, agjencitë tjera 10 milionë e 488 mijë euro, ndërkaq donatorët 4 milionë e 108 mijë euro, pra gjithsej 22 milionë e 232 mijë euro.

Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN), në vlerësimin afatmesëm të zbatimit të PSAK-së tregon se nga Fondi për Shkencë, MASHT ka ndarë nga 396 mijë euro në vitin 2017 dhe 2018, ndërkohë që në vitin 2019, janë ndarë 1 milion e 252 mijë euro.<sup>9</sup>

Në raportin “Borgjezia” e Akademisë (2019), ORCA kishte hulumtuar deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike në Kosovë, të publikuara në uebfaqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në hulumtim ishin përfshirë Këshilli Drejtues, Rektori, prorektorët, dekanët, dhe prodekanët e shtatë universiteteve publike.<sup>10</sup>

Në hulumtimin e deklaratave të pasurisë të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike për vitin 2019, ORCA ka gjetur se 159 profesorë me pozita menaxheriale në universitetet publike të Kosovës paguhen mesatarisht 1916 euro në muaj, nga të cilat mbi 696 euro janë shtesa (36% e të ardhurave mujore).

#### 5 PJESËTARËT E STAFIT MENAXHERIAL ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË MUAJ




9 KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021

10 Raporti “Borgjezia e Akademisë”, 2019, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Borgjezia-e-Akademis%C3%AB-1.pdf>


**Rektorët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2597 Euro në muaj**, nga të cilat mesatarisht 1243 Euro janë shtesa. Rektori i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit, me 2973 Euro në muaj. Nuk ka ndryshime domethënëse krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018, ku rektorët mesatarisht paguheshin 2517 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 1,171 Euro ishin shtesa.

#### TË ARDHURAT E REKTORËVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE




**Prorektorët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2132 Euro në muaj,** nga të cilat mesatarisht 863 Euro janë shtesa. Prorektori i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Myrvete Badivuku Pantina, prorektore për buxhet dhe financa në Universitetin e Prishtinës, me 2930 Euro në muaj. Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklaratimet e pasurisë së vitit 2018 ku të ardhurat mesatare të prorektorëve ishin 2301 Euro në muaj.

#### 5 PROREKTORËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË UNIVERSITETET PUBLIKE



**Dekanët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2066 Euro në muaj,** nga të cilat mesatarisht 837 Euro janë shtesa. Dekani i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Fevzi Berisha, dekan i Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, me 2706 Euro në muaj. Ka një rënie të shtesave krahasuar me deklaratimet e pasurisë së vitit 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 2202 Euro në muaj.


#### 5 DEKANËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË UNIVERSITETET PUBLIKE





**Prodekanët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 1798 Euro në muaj**, nga të cilat mesatarisht 581 Euro janë shtesa. Prodekani i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Vehbi Ramaj, prodekan në Fakultetin e Biznesit në Universitetin e Pejës, me 2725 Euro në muaj. Ka një rënie të shtesave krahasuar me deklaratimet e pasurisë së vitit 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 1927 Euro në muaj.

#### 5 PRODEKANËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË UNIVERSITETET PUBLIKE



Bajram Kosumi, rektor në Universitetin e Gjilanit, është më i paguari nga i gjithë stafi menaxherial i universiteteve publike me 2973 Euro në muaj. Krahasimisht, rroga më e lartë në Kosovë, ajo e presidentit, është 2390 Euro në muaj, sipas ligjit të ri të pagave për sektorin publik.<sup>11</sup>

Mesatarja e shpenzimeve për kokë studentit në universitete publike në vitin 2020, është vetëm 796 Euro.

<sup>11</sup> Ligji Nr. 06/L-111 Për Pagat Në Sektorin Publik. 01.03.2019, Link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18683>



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës<sup>12</sup>, Universiteti i Prishtinës (UP), në vitin akademik 2019/2020 ka gjithsej 891 punonjës akademikë të rregullt dhe 473 të angazhuar.

Në nivelin Bachelor, UP ka gjithsej 29 mijë e 531 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 6 mijë e 64 studentë, ndërsa kandidatë të pranuar në studimet e doktoratës ka gjithsej 78.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 17 mijë e 898 femra dhe 11 mijë e 633 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar gjatë vitit 2019, janë gjithsej 2 mijë e 979 femra dhe 1 mijë e 798 meshkuj, pra 4 mijë e 777 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 3 mijë e 687 femra dhe 2 mijë e 377 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar gjatë vitit 2019, janë gjithsej 975 femra dhe 829 meshkuj, pra 1 mijë e 804 të diplomuar.

Në doktoratë, janë gjithsej 53 femra dhe 25 meshkuj.

Raporti student-mësimdhënës del të jetë 40:1.

### Të gjetura nga Auditori

Në Raportin e Auditimit për Universitetin e Prishtinës për vitin 2019<sup>13</sup>, ishte gjetur se 79 profesorë në Universitetin e Prishtinës janë angazhuar me punë sekondare në universitete tjera publike për të cilat nuk kishin marrë miratimin paraprak nga rektori i UP-së.

Madje një prej këtyre profesorëve që ligjëron në Fakultetin e Filologjisë në UP, ishte i angazhuar me kontratë edhe në dy institucione të tjera, për të njëjtën periudhë kohore. Njëra kontratë ishte si profesor i rregullt në një kolegji privat dhe kontrata tjetër për honorar në Universitetin e Prizrenit.

“Angazhimet e profesorëve për punë shtesë pa miratimin e menaxhmentit, përveç se është në kundërshtim me kërkesat e rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, ndikon në cilësinë e procesit arsimor për shkak të angazhimeve të shumta të personelit akademik”, thuhet në raport, ndërkohë që është rekomanduar rishikimi i rasteve të identifikuara dhe marrja e masave përkatëse ndaj personelit i cili nuk i zbaton rregulloret.

<sup>12</sup> Raporti “Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20” i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, linku: [https://ask.rks-gov.net/media/5460/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB\\_2019-20\\_gjuheshqipe.pdf](https://ask.rks-gov.net/media/5460/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB_2019-20_gjuheshqipe.pdf)

<sup>13</sup> Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës, 2019, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raporti-auditimit-UP-2019-Shqip.pdf>

E gjetur tjetër është edhe shuma e kompensuar për kryetarët e komisioneve të doktoratës, të cilët sipas Rregullores për të ardhura personale, kompensimi për vlerësim dhe mbrojtje të temës është 200 Euro, ndërkohë që është vërejtur se janë bërë pagesa të ndryshme mes fakulteteve për punën e njëjtë. 200 Euro janë paguar kryetarët e komisioneve nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Filologjik, Fakulteti Filozofik dhe Fakulteti i Bujqësisë, ndërkohë që 350 Euro janë paguar kryetarët e komisioneve nga Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, kurse 400 Euro janë paguar kryetarët e komisioneve nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike. Të gjitha vendimet ishin nënshkruar nga prorektorja për buxhet dhe financa.

Ndërkohë që Zyra e Auditorit ka rekomanduar që kompensimet për kryetarin e komisionit të vlerësimit dhe mbrojtjes së temës së doktoratës të jenë konform rregullores dhe të njëjta për të gjitha fakultetet.

Tutje është gjetur se janë bërë kompensime në kundërshtim me Rregulloren për kompensimin e punës së komisioneve të cilat themelohen në nivel të universitetit, për arsye se kompensimi për punë shtesë dhe punë jashtë orarit nuk i takon rektorit, prorektorëve, anëtarëve të Këshillit Drejtues, sekretarit të përgjithshëm të UP-së, dekanëve, prodekanëve, sekretarëve të njësive akademike dhe drejtorëve të Administratës Qendrore, ndërkohë që sipas Raportit të Auditorit, në pesë raste janë kompensuar si anëtarë të komisionit për punë shtesë të cilat sipas zyrës për çështje akademike të UP-së, nuk konsiderohen si komisione profesionale. Vlera e këtyre kompensimeve ishte 1312 Euro.

Tutje është rekomanduar që të mos ketë kompensime të cila sipas rregullores nuk u takon kompensimi dhe aty ku janë identifikuar gabimet të ndërmerren masa për kthimin e mjeteve.

Nga dhjetë rekomandimet që i kishte dhënë Zyra e Auditorit për vitin 2018, katër ishin zbatuar, dy ishin zbatuar pjesërisht dhe katër prej tyre nuk ishin zbatuar fare.



Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Prishtinës, në vitin akademik 2019/2020 ka gjithsej 891 punonjës akademikë të rregullt dhe 473 të angazhuar.





## LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PRISHTINËS 2019 DHE 2020

Pagat dhe mëditjet	2019	21,263,857	61.13%
	2020	20,986,212	67.61%
Mallrat dhe shërbimet	2019	3,402,645	9.78%
	2020	3,222,513	10.38%
Shpenzimet komunale	2019	1,175,000	3.38%
	2020	809,326	2.61%
Subvencionet dhe transferet	2019	1,444,000	4.15%
	2020	1,444,000	4.65%
Shpenzimet kapitale	2019	7,500,000	21.56%
	2020	4,579,352	14.75%
<b>Total Shpenzimet</b>	2019	<b>34,785,502</b>	<b>100%</b>
	2020	<b>31,041,403</b>	

## Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Prishtinës, ishin ndarë gjithsej 34 milionë e 785 mijë e 502 euro vetëm për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, kjo shumë është zvogëluar për mbi 3 milionë euro meqenëse janë ndarë gjithsej 31 milionë e 41 mijë e 403 euro.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2019, shkonte për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 21 milionë e 263 mijë e 857 euro apo 61%, të parapara për 2 mijë e 81 të punësuar, gjë e cila nuk ka pësuar ndryshime të mëdha edhe për vitin 2020 sepse për paga dhe mëditje janë paraparë 20 milionë e 986 mijë e 212 euro apo 67.61%, për numrin e njëjtë të të punësuarve.









Për mallra dhe shërbime, UP-së i ishin ndarë 3 milionë e 402 mijë e 645 euro për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2020, kjo shumë është zbritur në 3 milionë e 222 mijë e 513 euro. Për shpenzime komunale gjatë vitit 2019, ishin paraparë 1 milionë e 175 mijë euro, ndërsa për vitin 2020, kjo shumë ka rënë në vetëm 809 mijë e 326 euro. Shuma e ndarë për subvencione dhe transfere në UP, përgjatë viteve 2019 dhe 2020 nuk ka ndryshuar, pra janë ndarë nga 1 milionë e 444 mijë euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dallon mes këtyre viteve për mbi 2 milionë euro, meqenëse për vitin 2019, janë ndarë gjithsej 7 milionë e 500 mijë euro, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 4 milionë e 579 mijë e 352 euro.

Në anën tjetër, shpenzimet vjetore për kokë studentit për vitin 2020 në Universitetin e Prishtinës janë vetëm 870 Euro.

## Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Prishtinës janë të rregulluara përmes Rregullores nr. 2/486 të datës 11.09.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Neni 8 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1429.54 euro
Profesorët e asocuar	 6	1283.34 euro
Profesorët asistent	 6	1137.14 euro
Ligjëruesit	 6	990.94 euro
Lektorët	 10	844.73 euro
Korepetitorët	 10	844.73 euro
Asistentët	 10	772.50 euro
Asistent i ri	 10	698.75 euro

**Tabela 1.** Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Prishtinës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Prishtinës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	500 euro
Prorektor	450 euro
Dekan	350 euro
Prodekan	250 euro

**Tabela 2.** Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Prishtinës

Personeli akademik në Universitet të Prishtinës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 6 orë në javë (profesorët) dhe deri në 10 orë në javë (lektorët, asistentët e korepetitorët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

<b>Titulli</b>	<b>Shtesa</b>
<b>Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)</b>	25 euro
<b>Ligjërues, lektor</b>	15 euro
<b>Asistent, korepetitorë</b>	13 euro

**Tabela 3.** Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

<b>Komisioni</b>	<b>BA</b>	<b>MA</b>	<b>PHD</b>
<b>Mentori</b>	20 euro	150 euro	1200 euro
<b>Kryetari i komisionit</b>	n/a	60 euro	200 euro
<b>Anëtar i komisionit</b>	10 euro	50 euro	150 euro

**Tabela 4.** Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Personeli akademik gjithashtu kompensohet edhe për pjesëmarrje në komisione të ndryshme në kuadër të punës në universitet, si dhe për pjesëmarrje në Senat, sipas nenit 22.

## Analiza e të dhënave nga deklarinimet e pasurisë

Në analizën e deklarinimeve të pasurisë për Universitetin e Prishtinës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1736 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 405 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 24% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë së vitit 2019 ku të ardhurat mesatare ishin 2381 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 988 Euro në muaj.

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 2521 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 1120 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 41% të rrogës së tyre mujore. Dy prorektorë marrin më shumë shtesa se rroga e tyre bazë. Nuk ka ndryshime domethënëse nga deklarinimet e pasurisë për vitin 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 2555 Euro dhe shtesat mesatare 1184 Euro në muaj.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 2232 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 895 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 40% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë së vitit 2019 ku të ardhurat mesatare ishin 2418 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 1069 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 1841 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 606 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë 33% të rrogës së tyre mujore. Dy prodekanë marrin më shumë shtesa se rroga bazë. Ka rënie të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë së vitit 2019 ku të ardhurat mesatare ishin 2000 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 730 Euro në muaj.<sup>14</sup>



Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen **1736 Euro** në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin **405 Euro** në muaj në shtesa.

Këto shtesa përbëjnë rreth **24%** të rrogës së tyre mujore.

<sup>14</sup> Hazbije Sahiti ka deklaruar në deklarinimin e pasurisë që merr 7,756.00 Euro nga Universiteti i Prishtinës. Kjo shumë nuk përkon me shumën e tjera të deklaruara nga kolegët e saj. Për këtë arsye, prodekanja është larguar nga analiza.

		2018	2019
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	2381 €	1736 €
	Rektorati	2555 €	2521 €
	Dekanët	2418 €	2232 €
	Prodekanët	2000 €	1804 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	988 €	405 €
	Rektorati	1184 €	1120 €
	Dekanët	1068 €	895 €
	Prodekanët	730 €	606 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	2200 € 2630 €	1313 € 1995 €
	Rektorati	2072 € 3125 €	1980 € 2930 €
	Dekanët	1910 € 3367 €	1743 € 2706 €
	Prodekanët	1283 € 3352 €	1283 € 2707 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	815 € 1200 €	177 € 566 €
	Rektorati	861 € 1694 €	697 € 1501 €
	Dekanët	505 € 1937 €	606 € 1277 €
	Prodekanët	0 1922 €	103 € 1423 €

## Fondi për shkencë

Nuk ka informacion publik për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2019, ndërkaq sipas ndarjeve të buxhetit për vitin 2020, nga kategoria subvencione dhe transfere bëhet financimi i aktiviteteve shkencore në UP në vlerë prej 1% të buxhetit të përgjithshëm të universitetit ose në shumën prej 367 mijë e 339 euro.

## Bursa për studentë

Nga kategoria subvencione dhe transfere në të cilën ishin shpenzuar 653 mijë e 319 euro, UP për vitin akademik 2018/19<sup>15</sup> kishte ndarë bursa për 1 mijë e 58<sup>16</sup> studentë të nivelit Bachelor, me shumën prej 600 euro për 10 muaj të vitit akademik, ndërkohë që për vitin akademik 2019/2020<sup>17</sup>, për 1 mijë e 64 studentë<sup>18</sup> të nivelit Bachelor janë ndarë



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë për vitin 2019, me shumën që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuar për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 1.**

15 Vendimi i Këshillit Drejtues të UP-së për ndarjen e bursave, 2018, linku: <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/6A15A790-53FD-4ADD-B74D-DF4385B583E6.pdf>

16 Lista e bursistëve të UP-së, 2018/19, linku: [https://drive.google.com/drive/folders/1YDQUwbbByHAS-65VtOUkPRXn-1mD6Q3mB?fbclid=IwAR2\\_uY0h-HUNlMtriebyER80i7a1Eg2RB8lp6ZPuhwgnz-27uQ-1baJ2E2j0](https://drive.google.com/drive/folders/1YDQUwbbByHAS-65VtOUkPRXn-1mD6Q3mB?fbclid=IwAR2_uY0h-HUNlMtriebyER80i7a1Eg2RB8lp6ZPuhwgnz-27uQ-1baJ2E2j0)

17 Vendimi i Këshillit Drejtues të UP-së për ndarjen e bursave, 2019, linku: <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/014E3BD0-4DCF-4270-A3BB-3A1EB618FFD3.pdf>

18 Lista e bursistëve të UP-së, 2019/20, linku: <https://drive.google.com/drive/u/0/folders/1QNT3mDWvNy-IZYtj9paiTG9IDuHlPsWRq?fbclid=IwAR0JIAtMffuJJ-7EuKnfQycoJq-Mieqwbx2zyXUsNLLsWti4EWYF3x-7uK03o>



bursa me shumën prej 650 euro për 10 muaj të vitit akademik, e të cilat kapin shumën prej 638 mijë e 400 euro.

shumë prej 800 mijë euro dhe ndërtimi i objektit për FSHMN me shumën prej 450 mijë euro.

## Investimet kryesore kapitale

Sipas Raportit të Auditorit për UP-në, janë shpenzuar gjithsej 3 milionë e 90 mijë e 155 euro për këtë kategori për vitin 2019 dhe se kryesisht janë bërë furnizime me pajisje laboratorike, renovim i objekteve universitare, etj. Në përgjigjet zyrtare të UP-së, janë listuar gjithsej 9 projekte kapitale, siç janë: Mjete konkretizimi me shumën prej 110 mijë e 681 euro, Laboratorë për UP-në me shumën prej 792 mijë e 999 euro, Objekti i ri i Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë me shumën prej 277 mijë e 835 euro, Blerja e veturave për UP-në me shumën prej 38 mijë e 574 euro, Renovimi i objekteve universitare me shumën prej 1 milionë e 44 mijë e 659 euro, Blerja e makinerive bujqësore për Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë me shumën prej 4 mijë e 250 euro, Investimi në Qendrën për Hulumtime Bashkëkohore në fushën e Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjisë së Informacionit me shumën prej 410 mijë e 944 euro, Pajisje për Institutin Shkencor në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës me shumën prej 317 mijë e 710 euro, si dhe Inventar për objektin e ri të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë me shumën prej 92 mijë e 500 euro. Ndërkaq sipas ndarjeve të buxhetit për vitin 2020, mes tjerash UP ka këto tri projekte të mëdha; Revitalizimi i laboratorëve në FSHMN 2018-2020 me shumën prej 800 mijë euro, hidroizolimi dhe drenazhimi i themeleve dhe bodrumeve në objektet e FSHMN, F. Filozifik dhe F. Filologjik me

## Sigurimi fizik i objekteve

Sipas përgjigjeve zyrtare të UP-së, gjatë vitit 2019 janë shpenzuar gjithsej 575 mijë e 207 euro për këtë kategori, ndërkaq për vitin 2020, UP e ka të planifikuar të shpenzojë gjithsej 600 mijë euro për sigurimin fizik të objekteve për një vit.

## Shpenzimet gjyqësore

Në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2019<sup>19</sup>, nga Thesari i shtetit janë shpenzuar gjithsej 465 mijë e 59 euro si pasojë e vendimeve të gjykatave, prej tyre 331 mijë e 775 euro ishin obligime të viteve të mëhershme të UP-së ndaj ATK-së për kontributet pensionale dhe tatimet e mbajtura në burim për shtesat e profesorëve që nuk ishin paguar. Pjesa prej 133 mijë e 284 euro ishin për pagesën e pagave jubilarë për stafin akademik dhe nga faturat që nuk ishin paguar me kohë. Prej tyre borxhi kryesor ishte 124 mijë e 272 euro dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbarimit) ishin 9 mijë e 12 euro<sup>20</sup>. Ndërsa për vitin 2018-të, UP kishte shpenzuar 337 mijë e 423 euro për vendime gjyqësore. Në përgjigjen zyrtare nga UP, thuhet se për vitin 2019, shpenzime gjyqësore janë gjithsej 140 mijë e 667 euro, duke shtuar se është bërë edhe likuidimi i një pjese të obligimeve ndaj ATK-së, në vlerë prej 331 mijë e 51 euro.

<sup>19</sup> Raporti vjetor financiar i buxhetit të Repulikës së Kosovës, 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1E29A660-3716-465F-A1E8-C99AD78E6318.pdf>

<sup>20</sup> Raporti i Auditimit për UP-në, 2019, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raporti-auditimit-UP-2019-Shqip.pdf>



## UNIVERSITETI I PRIZRENIT

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Prizrenit (UPZ), ka gjithsej 77 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 24 apo 31% gra, si dhe 87 të angazhuar, prej tyre 32 apo 37% gra.

Universiteti i Prizrenit, në nivelin Bachelor ka gjithsej 3 mijë e 776 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 259 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 2 mijë e 776 femra dhe 1 mijë meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 620 femra dhe 237 meshkuj, pra 857 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 144 femra dhe 115 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 109 femra dhe 92 meshkuj, pra 201 të diplomuar.

Raporti student-mësimdhënës në Universitetin e Prizrenit del të jetë 52:1.

### Të gjetura nga Auditori

Në Raportin e Auditimit për MASHT-in për vitin 2018<sup>21</sup>, ishte gjetur parregullsi për “Pagesat e bëra për profesorët në Universitetin e Prizrenit për orët mbi normë”, Zyra e Auditorit kishte gjetur se dy profesorëve u ishte bërë kompensimi për orët mbinormë, edhe pse nuk kishte dëshmi se orët janë mbajtur. Menaxhmenti i këtij universiteti, i kishte thënë Zyrës së Auditorit se kompensimi ishte bërë duke u bazuar në mbajtjen e provimeve, edhe pse mbajtja e provimeve ishte paraparë të kryhet në kuadër të orëve të rregullta.

Kjo zyrë i kishte rekomanduar ministrit të Arsimit dhe Rektorit të universitetit, që të sigurohen se pagesat do të bëhen vetëm për orët e mbajtura jashtë norme, dhe pagesat pa dëshmi për mbajtjen e orëve mësimore të kthehen në buxhetin e ministrisë. Ndërkohë në Raportin e vitit 2019, është bërë e ditur se rekomandimi është mbyllur nga MASHT-i pa u zbatuar.

<sup>21</sup> Raporti i auditimit për MASHT, 2018, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/06/Raporti-MASHT-E.pdf>



## Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Prizrenit, ishin ndarë gjithsej 2 milionë e 826 mijë e 772 euro vetëm për vitin 2019, ndërkaq për vitin 2020, janë ndarë 2 milionë e 245 mijë e 14 euro.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2019, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 853 mijë e 772 euro apo 65%, të parapara për 147 të punësuar, ndërsa për vitin 2020, shuma për këtë kategori është zvogëluar për mbi 200 mijë, meqenëse janë ndarë 1 milionë e 650 mijë e 728 euro apo 73.53%, për të njëjtin numër të të punësuarve.

Për mallra dhe shërbime, UPZ-së i ishin ndarë 600 mijë euro për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2020, kjo shumë është zbritur në 350 mijë euro. Për shpenzime komunale gjatë vitit 2019, ishin paraparë 73 mijë euro, ndërkaq për vitin 2020, kjo shumë ka rënë në vetëm 44 mijë e 286 euro. Shuma e ndarë për subvencione dhe transfere në UPZ, përgjatë viteve 2019 dhe 2020 nuk ka ndryshuar, pra janë ndarë nga 100 mijë euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dallon mes këtyre viteve për 100 mijë euro, meqenëse për vitin 2019, janë ndarë gjithsej 200 mijë euro, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 100 mijë euro.

Shpenzimet vjetore për kokë studentit, në Universitetin e Prizrenit për vitin 2020 janë vetëm 556 Euro.

## LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PRIZRENIT 2019 DHE 2020

Pagat dhe mëditjet	2019	1,853,772.00	65.58%
	2020	1,650,728.00	73.53%
Mallrat dhe shërbimet	2019	600,000.00	21.23%
	2020	350,000.00	15.59%
Shpenzimet komunale	2019	73,000.00	2.58%
	2020	44,286.00	1.97%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000.00	3.54%
	2020	100,000.00	4.45%
Shpenzimet kapitale	2019	200,000.00	7.08%
	2020	100,000.00	4.45%
<b>Total Shpenzimet</b>	2019	<b>2,826,772</b>	<b>100%</b>
	2020	<b>2,245,014</b>	

## Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Prizrenit janë të rregulluara përmes Rregullores të datës 18.01.2019 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti".<sup>22</sup> Neni 8 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1486.72 euro
Profesorët e asocuar	 6	1334.67 euro
Profesorët asistent	 6	1182.62 euro
Ligjëruesit	 6	1030.57 euro
Lektorët	 10	878.52 euro
Korepetitorët	 10	878.52 euro
Asistentët	 10	803.40 euro
Asistent i ri	 10	726.70 euro

**Tabela 1.** Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Prizrenit

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Prizrenit, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	600 euro
Prorektor	450 euro
Dekan	350 euro
Prodekan	250 euro

**Tabela 2.** Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Prizrenit

<sup>22</sup> Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin "Ukshin Hoti". 18.01.2019, link: [https://uni-prizren.com/repository/docs/RREGULLORJA\\_NR\\_01-11\\_-\\_2019\\_247988.pdf](https://uni-prizren.com/repository/docs/RREGULLORJA_NR_01-11_-_2019_247988.pdf)

Personeli akademik në Universitet të Prizrenit ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 6 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët e korepetitorët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
<b>Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)</b>	25 euro
<b>Ligjërues, lektor</b>	15 euro
<b>Asistent, korepetitorë</b>	13 euro

**Tabela 3.** Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

Komisioni	BA	MA	PHD
<b>Mentori</b>	20 euro	150 euro	1200 euro
<b>Kryetari i komisionit</b>	n/a	50 euro	300 euro
<b>Anëtar i komisionit</b>	10 euro	30 euro	200 euro

**Tabela 4.** Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Personeli akademik gjithashtu kompensohet edhe për pjesëmarrje në komisione të ndryshme në kuadër të punës në universitet, si dhe për pjesëmarrje në Senat, sipas neneve 20 dhe 21.

## Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratimeve të pasurisë për Universitetin e Prizrenit janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët. Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1915 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 733 Euro në muaj në

		2018	2019
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1604 €	1915 €
	Rektorati	2199 €	2080 €
	Dekanët	2120 €	2208 €
	Prodekanët	1618 €	1783 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	394 €	733 €
	Rektorati	989 €	860 €
	Dekanët	861 €	873 €
	Prodekanët	452 €	550 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1446 € 1888 €	1483 € 2260 €
	Rektorati	1854 € 2551 €	1738 € 2738 €
	Dekanët	1500 € 2817 €	2024 € 2398 €
	Prodekanët	1374 € 2010 €	1350 € 2217 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	17 € 751 €	301 € 1077 €
	Rektorati	717 € 1268 €	556 € 1403 €
	Dekanët	217 € 1534 €	689 € 1063 €
	Prodekanët	237 € 873 €	167 € 882 €

shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 38% të rrogës së tyre mujore. Këto të ardhura janë më të larta krahasuar me ato të vitit 2018, ku të ardhurat ishin 1604 Euro në muaj dhe 364 Euro shtesa.

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 2080 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 860 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 41% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 2199 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 989 Euro në muaj. Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 2208 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 873 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë 40% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të të ardhurave krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 2120 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 861 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 1783 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 550 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 31% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të të ardhurave krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 1618 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 542 Euro në muaj.



Të dhënat e detajuara sipas deklaratimeve të pasurisë për vitin 2019, me shumatat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuara për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 2.**

### **\*Fondi për shkencë**

Sipas të dhënave të siguruara nga UPZ, buxheti i shpenzuar për kontributin ndaj shkencës kap shumën prej 18 mijë euro për anëtarësime, ndërkohë që për vitin 2020 janë paraparë 25 mijë euro. Sa i përket shpenzimeve për botimin e publikimeve, në vitin 2019 janë shpenzuar 2 mijë euro, ndërkohë që janë paraparë 5 mijë euro për vitin 2020.

### **\*Bursa për studentë**

Nuk ka informacion publik për shumën e bursës, ndërkohë që shpenzimet e paguara për vitin akademik 2018/2019<sup>23</sup> ishin 100 mijë euro nga të cilat përfituan 154 studentë, kurse planifikimi për vitin 2019/2020 sipas UPZ-së është 100 mijë euro për 150 studentë.

### **\*Investimet kryesore kapitale**

Nuk ka të dhëna publike që tregojnë për numrin, llojin apo shpenzimet për projektet me investime kapitale për vitin 2019 apo planifikimin për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet e pranuar nga UPZ, thuhet se në vitin 2019, janë shpenzuar gjithsej 44 mijë e 900 euro në pajisje laboratorike, ndërkohë që për vitin 2020, janë planifikuar të shpenzohen 200 mijë euro.

### **\*Sigurimi fizik i objekteve**

Nuk ka informacion publik për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2019 dhe planifikimin për vitin 2020 mirëpo në përgjigjet e pranuar nga UPZ, thuhet se në vitin 2019, janë shpenzuar gjithsej 32 mijë euro dhe se për vitin 2020, janë planifikuar 50 mijë euro.

### **\*Shpenzimet gjyqësore**

Nuk ka informacion publik për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2019 mirëpo në përgjigjet e pranuar nga UPZ, thuhet se në vitin 2019, janë shpenzuar gjithsej 654 euro.

<sup>23</sup> Konkursi për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2018/19, 2020, linku: [https://uni-prizren.com/repository/docs/KONKURS\\_BURSA\\_58540.pdf](https://uni-prizren.com/repository/docs/KONKURS_BURSA_58540.pdf)



## UNIVERSITETI I PEJËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Pejës (UHZ), ka gjithsej 70 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 30% gra, si dhe 40 të angazhuar, prej tyre 9% gra.

Universiteti i Pejës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 9 mijë e 613 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 1 mijë e 470 student, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 3 mijë e 916 femra dhe 5 mijë e 697 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 276 femra dhe 143 meshkuj, pra 419 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 840 femra dhe 630 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 128 femra dhe 73 meshkuj, pra 201 të diplomuar.

Raporti student-mësimdhënës del të jetë 158:1.

### Të gjetura nga Auditori

Ndërkohë Zyra e Auditorit kishte gjetur se gjashtë profesorë në Universitet të Pejës, kishin kryer shkelje të Rregullores për të ardhura personale për stafin akademik në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Këta profesorë, të cilët kishin marrëdhënie të rregullt të punës dhe kontratë me orë mbinormë me Universitetin e Pejës, ishin angazhuar me kontratë pune me honorarë edhe në universitete tjera.

Dy prej tyre ishin të angazhuar në Universitetin e Prizrenit, një në Universitetin e Ferizajt dhe tre profesorë në Universitetin e Prishtinës, gjë që përbën shkelje të Rregullores për të ardhura personale në Universitet të Pejës.

UHZ u kishte kërkuar këtyre profesorëve që të deklarojnë pagën sekondare dhe nëse nuk kanë të tillë, ta nënshkruajnë deklaratën se nuk kanë angazhime shtesë.

Gjashtë profesorët e UHZ-së kishin nënshkruar këtë deklaratë edhe pse në të njëjtën kohë kanë qenë të angazhuar dhe janë paguar edhe nga universitetet tjera me honorar.



Zyra e Auditorit kishte rekomanduar që Ministri bashkë me Rektorët e universiteteve, të sigurojnë monitorim ndaj personelit akademik në mënyrë që angazhimet e tyre të jenë në harmoni me rregulloren dhe për të gjitha rastet si ky, të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve dhe statusi i ardhshëm i angazhimit të këtij stafi. Mirëpo në raportin e fundit thuhet se “nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi”, andaj edhe është mbyllur pa u zbatuar.

## Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Pejës, janë ndarë gjithsej 3 milionë e 628 mijë e 197 euro vetëm për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 3 milionë e 542 mijë e 984 euro.


Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2019, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 2 milionë e 95 mijë e 782 euro apo 57%, të parapara për 162 të punësuar, ndërkaq për vitin 2020 është zvogëluar për mbi 200 mijë sepse për këtë kategori janë ndarë 1 milionë e 832 mijë e 717 euro, për numrin e njëjtë të të punësuarve si vitin e kaluar.

Për mallra dhe shërbime, UHZ-së i ishin ndarë 412 mijë e 7 euro për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2020, kjo shumë është rritur në 477 mijë e 7 euro. Për shpenzime komunale gjatë vitit 2019, ishin paraparë 50 mijë e 408 euro, ndërkaq për vitin 2020, kjo shumë ka rënë në 304 mijë e 760 euro. Shuma e ndarë për subvencione dhe transfere në UHZ, përgjatë viteve 2019 dhe 2020 nuk ka ndryshuar, pra janë ndarë nga 100 mijë euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dallon mes këtyre viteve për mbi 100 mijë euro, meqenëse për vitin 2019, janë ndarë gjithsej 970 mijë euro, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 1 milionë e 102 mijë e 500 euro.




Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Pejës, ka gjithsej

**70 punonjës** akademik të rregullt, prej tyre,



si dhe **40** të angazhuar, prej tyre





## LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PEJËS 2019 DHE 2020

Pagat dhe mëditjet	2019	2,095,782.00	57.76%
	2020	1,832,717.00	51.73%
Mallrat dhe shërbimet	2019	412,007.00	11.36%
	2020	477,007.00	13.46%
Shpenzimet komunale	2019	50,408.00	1.39%
	2020	30,760.00	0.87%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000.00	2.76%
	2020	100,000.00	2.82%
Shpenzimet kapitale	2019	970,000.00	26.74%
	2020	1,102,500.00	31.12%
<b>Total Shpenzimet</b>	2019	<b>3,628,197</b>	<b>100%</b>
	2020	<b>3,542,984</b>	

Në raportin vjetor të buxhetit të UHZ-së për vitin 2019<sup>24</sup>, të hyrat nga pagesat e studentëve kanë arritur vlerën prej 194 mijë e 804 euro.

Shpenzimet për paga dhe mëditje, kanë arritur vlerën prej 2 milionë e 87 mijë e 166 euro. Për mallra dhe shërbime, 495 mijë e 545 euro. Shpenzimet komunale kanë arritur shumën prej 34 mijë e 37 euro.

Për subvencione dhe transfere, UHZ ka deklaruar se shpenzimet kanë arritur vlerën prej 72 mijë e 238 euro. Ndërkaq, shpenzimet kapitale, kapin vlerën prej 662 mijë e 347 eurove.

Shpenzimet për studentë në vitin 2020 janë 320 euro për kokë studentit.

### Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Pejës janë të rregulluara përmes Rregullores të datës 08.03.2018 për të ardhurat personale, shtesat funksionale dhe honoraret të personelit akademik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.<sup>25</sup>

Neni 7 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

<sup>24</sup> Raporti vjetor i departamentit për buxhet dhe financa në Universitetin e Pejës, 2019, linku: <https://drive.google.com/file/d/1jDge9GX4GKJRjwoPDMX-KryHNAltksmNc/view>

<sup>25</sup> Rregullorja për të ardhurat personale, shtesat funksionale dhe honoraret të personelit akademik në Universitetin «Haxhi Zeka» në Pejë. 08.03.2018 Link: <https://drive.google.com/file/d/1DsiA4YBmLMDqA-wKU3di2gFP6CV4B5Fg/view>

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1429.54 euro
Profesorët e asocuar	 6	1283.34 euro
Profesorët asistent	 6	1137.14 euro
Lektorët/Korepetitorët	 10	844.73 euro
Asistentët	 10	772.50 euro

**Tabela 1.** Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Pejës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Pejës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	600 euro
Prorektor	400 euro
Dekan	300 euro
Prodekan	200 euro

**Tabela 2.** Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Pejës

Personeli akademik në Universitet të Pejës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 6 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	30 euro
Lektor, asistent	15 euro

**Tabela 3.** Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	30 euro	150 euro	1000 euro
Kryetari i komisionit	n/a	70 euro	300 euro
Anëtar i komisionit	10 euro	60 euro	250 euro

**Tabela 4.** Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

## Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratimeve të pasurisë për Universitetin e Pejës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1400 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 385 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 27% të rrogës së tyre mujore. Të ardhurat janë të ngashme me ato të vitit 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 1407 Euro në muaj dhe 343 Euro shtesa.<sup>26</sup>

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 2428 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 1108 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 46% të rrogës së tyre mujore. Të ardhurat janë të ngashme me ato të vitit 2018, ku të ardhurat mesatare ishin 2397 Euro në muaj dhe 1110 euro shtesa. Një prorektor merr më shumë shtesa në muaj se sa rroga bazë.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 2320 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 1037 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 45% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të të ardhurave krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 ku të ardhurat mesatare

<sup>26</sup> Gentiana Gega ka deklaruar në deklaratimin e pasurisë që merr 5,069.91 € Euro nga Universiteti i Pejës. Kjo shumë nuk përkon me shumën e tjera të deklaruara nga kolegët e saj. Për këtë arsye, anëtarja e Këshillit Drejtues është larguar nga analiza.

ishin 2145 Euro në muaj, prej tyre 978 Euro shtesa. Një dekan merr më shumë shtesa në muaj se sa rroga bazë.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 1977 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 756 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 38% të rrogës së tyre mujore. Të ardhurat janë të ngashme me ato të vitit 2018, ku të ardhurat mesatare ishin 1995 Euro në muaj dhe 785 Euro shtesa. Një prodekan merr më shumë shtesa në muaj se sa rroga bazë.



Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen **1400 Euro** në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin **385 Euro** në muaj në shtesa.

Këto shtesa përbëjnë rreth **27%** të rrogës së tyre mujore.

2018

2019

	Këshilli Drejtues	1407 €	1404 €
Mesatarja e të ardhurave mujore	Rektorati	2397 €	2428 €
	Dekanët	2145 €	2320 €
	Prodekanët	1995 €	1977 €
	Këshilli Drejtues	343 €	385 €
Mesatarja e shtesave	Rektorati	1110 €	1108 €
	Dekanët	978 €	1037 €
	Prodekanët	785 €	756 €
	Këshilli Drejtues	756 € 2166 €	1210 € 1600 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Rektorati	1684 € 2827 €	1874 € 2828 €
	Dekanët	1792 € 2710 €	1794 € 2677 €
	Prodekanët	1612 € 2561 €	1391 € 2725 €
	Këshilli Drejtues	0, 883 €	254 € 462 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Rektorati	547 € 1398 €	591 € 1545 €
	Dekanët	655 € 1573 €	511 € 1393 €
	Prodekanët	392 € 1424 €	245 € 1588 €



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë për vitin 2019, me shumat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuara për 12 muaj mund t'i gjeni në

**aneksin numër 3.**

### \*Fondi për shkencë

Sipas UHZ-së, gjatë vitit 2019 janë shpenzuar gjithsej 17 mijë e 473 euro për kërkime shkencore, ndërkohë që planifikimi për shpenzime në këtë kategori gjatë vitit 2020, është 50 mijë euro.

### \*Bursa për studentë

Nuk ka të dhëna që informojnë për shumën e bursës dhe atë të shpenzuar për këtë kategori për vitin akademik 2018/2019, përmes të cilës kanë përfituar gjithsej 42 studentë<sup>27</sup>, ndërkohë që për vitin akademik 2019/2020, shuma totale e shpenzuar për bursa sipas UHZ-së, është 64 mijë e 800 euro, prej të cilës kanë përfituar gjithsej 72 studentë nga 900 euro. Shuma e planifikuar për vitin akademik 2020/2021, është 50 mijë euro.

### \*Investimet kryesore kapitale

Për vitin 2019, UHZ ka paguar gjithsej 662 mijë e 347 euro për këto projekte kapitale; ndërtim dhe renovim i infrastrukturës së UHZ-së në të cilin janë shpenzuar 609 mijë e 363 euro, blerja e pajisjeve për UHZ-në në të cilin janë shpenzuar 33 mijë e 527 euro, si dhe blerja e pajisjeve laboratorike për UHZ-në në të cilin janë shpenzuar 19 mijë e 457 euro. Ndërkaq janë ndarë gjithsej 1 milionë e 102 mijë e 500 euro për vitin 2020, për këto projekte; ndërtim dhe renovim i infrastrukturës me shumën prej 1 milionë e 50

mijë euro, pajisje tjera me shumën prej 37 mijë e 500 euro, si dhe pajisje laboratorike me shumën prej 15 mijë euro.

### \*Sigurimi fizik i objekteve

Për vitin 2018, UHZ ka paguar gjithsej 63 mijë e 908 euro për sigurim të ndërtesave, ndërsa për vitin 2019, kjo shumë ka rënë në 58 mijë e 147 euro. Ndërkohë që janë planifikuar të shpenzohen 59 mijë e 147 euro për vitin 2020.

### \*Shpenzimet gjyqësore

Për vitin 2018-të, UHZ ka paguar 45 mijë e 279 euro si pasojë e vendimeve të gjykatave ndërsa sipas raportit vjetor<sup>28</sup>, gjatë vitit 2019 UHZ nuk ka paguar për shpenzime gjyqësore.

27 Vendim mbi ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2018/19, 2018, linku: <http://unhz.eu/wp-content/uploads/2018/11/3240-Vendim-mbi-ndarjen-e-bursave-universitare-p%C3%ABr-vitin-akademik-2018-2019.pdf>

28 Raporti vjetor i departamentit për buxhet dhe financa në Universitetin e Pejës, 2019, linku: <https://drive.google.com/file/d/1jDge9GX4GKJRjwoPDMXKryHNAItksmNc/view>



## UNIVERSITETI I GJAKOVËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Gjakovës (UGJFA), ka gjithsej 50 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 22 apo 44% gra, si dhe 32 të angazhuar, prej tyre 14 apo 44% gra.

Universiteti i Gjakovës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 1 mijë e 653 studentë, në nivelin Master nuk ka studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 399 femra dhe 254 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 318 femra dhe 63 meshkuj, pra 381 të diplomuar.

Raporti student-mësimdhënës del të jetë 33:1.

### **Analiza e shpenzimeve**

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Gjakovës, janë ndarë gjithsej 2 milionë e 460 mijë e 46 euro vetëm për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 1 milionë e 974 mijë e 755 euro.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2019 dhe 2020, për paga dhe mëditje të stafit akademik, është nga 1 milionë e 243 mijë e 707 euro apo 50% për 2019 dhe 62.98% për 2020, të parapara për 111 të punësuar.

Për mallra dhe shërbime, UGJFA-së i ishin ndarë 316 mijë e 339 euro për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2020, kjo shumë është zbritur në 256 mijë e 339 euro. Për shpenzime komunale gjatë vitit 2019, ishin paraparë 50 mijë euro, ndërkaq për vitin 2020, kjo shumë ka rënë në vetëm 30 mijë e 859 euro. Shuma e ndarë për subvencione dhe transfere në UGJFA, përgjatë viteve 2019 dhe 2020 nuk ka ndryshuar, pra janë ndarë nga 100 mijë euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dallon mes këtyre viteve për mbi 400 mijë euro, meqenëse për vitin 2019, janë ndarë gjithsej 750 mijë euro, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 343 mijë e 850 euro.





Sipas Raportit Vjetor Financiar për vitin 2019 të publikuar nga Universiteti i Gjakovës<sup>29</sup>, shpenzimet për paga dhe mëditje janë 1 milionë e 133 mijë e 481 euro. Për mallra dhe shërbime, 278 mijë e 891 euro. Për shpenzime komunale janë 29 mijë e 147 euro. Për subvencione dhe transfere 81 mijë e 750 euro, si dhe për shpenzime kapitale 0 euro. Sipas këtij raporti, për vitin 2019, janë shpenzuar gjithsej 1 milionë e 523 mijë e 270 euro.

Shpenzimet për studentë në vitin 2020 janë 1195 Euro për kokë studenti.

## Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Gjakovës janë të rregulluara përmes Rregullores për të ardhura personale në Universitetin Publik në Gjakovë.<sup>30</sup>

Neni 8 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

<sup>29</sup> Raport vjetor i buxhetit të Universitetit të Gjakovës, 2019, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1583161022-Raporti%20Vjetor%20Financiar%202019%20UGJFA%20PDF.pdf>

<sup>30</sup> 18. Rregullorja për të Ardhura Personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honoraret dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani". 21.10.2019. Link: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/42253-Rregullore%20per%20te%20ardhurat%20personale%20ne%20upgj.pdf>

## LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E GJAKOVËS 2019 DHE 2020

Pagat dhe mëditjet	2019	1,243,707.00	50.56%
	2020	1,243,707.00	62.98%
Mallrat dhe shërbimet	2019	316,339.00	12.86%
	2020	256,339.00	12.98%
Shpenzimet komunale	2019	50,000.00	2.03%
	2020	30,859.00	1.56%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000.00	4.06%
	2020	100,000.00	5.06%
Shpenzimet kapitale	2019	750,000.00	30.49%
	2020	100,000.00	5.06%
<b>Total Shpenzimet</b>	2019	<b>2,460,046</b>	<b>100%</b>
	2020	<b>1,974,755</b>	

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1484.72 euro
Profesorët e asocuar	 6	1334.67 euro
Profesorët asistent	 6	1182.62 euro
Ligjëruesit	 6	1030.57 euro
Lektorët	 10	878.52 euro
Asistentët	 10	878.52 euro
Asistent i ri	 10	726.70 euro

**Tabela 1.** Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Gjakovës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Gjakovës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	500 euro
Prorektor	450 euro
Dekan	350 euro
Prodekan	250 euro

**Tabela 2.** Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Gjakovës

Personeli akademik në Universitet të Gjakovës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 5 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	25 euro
Ligjërues, lektor, asistent	13 euro

**Tabela 3.** Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	20 euro	150 euro	1200 euro
Kryetari i komisionit	n/a	50 euro	300 euro
Anëtar i komisionit	10 euro	30 euro	200 euro

**Tabela 4.** Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

## Analiza e të dhënave nga deklarinimet e pasurisë

Në analizën e deklarinimeve të pasurisë për Universitetin e Gjakovës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët. Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhën 1707 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 551 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 32% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të të ardhurave mesatare krahasuar me deklarinimet e pasurisë për vitin 2018, ku të ardhurat mesatare ishin 1407 Euro në muaj.

		2018	2019
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1437 €	1707 €
	Rektorati	2346 €	2092 €
	Dekanët	2149 €	2224 €
	Prodekanët	N/A	1278 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	533 €	551 €
	Rektorati	1359 €	882 €
	Dekanët	1454 €	892 €
	Prodekanët	N/A	140 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1240 € 1780 €	1181 € 2135 €
	Rektorati	2195 € 2636 €	1583 € 2610 €
	Dekanët	2105 € 2787 €	2165 € 2330 €
	Prodekanët	N/A	1225 € 1330 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	294 € 871 €	408 € 851 €
	Rektorati	1066 € 1727 €	300 € 1473 €
	Dekanët	962 € 1878 €	746 € 1047 €
	Prodekanët	N/A	88 € 193 €

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 2092 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 882 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 42% të rrogës së tyre mujore. Krahasuar me vitin 2018, shumata mesatare shtesat kanë rënë meqenëse të ardhurat e tyre mesatare ishin 2346 Euro në muaj, ndërsa shtesat 1359 Euro.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 2224 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 892 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë 40% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të të ardhurave krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 ku të ardhurat mesatare ishin 2149 Euro në muaj, prej tyre 1454 Euro shtesa.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 1278 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 140 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë 11% të rrogës së tyre mujore.



Të dhënat e detajuara sipas deklaratimeve të pasurisë për vitin 2019, me shumata që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuar për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 4.**

### \*Fondi për shkencë

Sipas UGJFA-së, ky fond mbulohet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe nga ajo e subvencioneve dhe transferëve, gjatë vitit 2019 janë shpenzuar gjithsej 31 mijë e 526 euro, ndërkohë që për vitin 2020, janë planifikuar të shpenzohen 40 mijë euro.

me vlerë prej 8 mijë e 439 euro, rregullimi i parkingut dhe renovimi i zyreve në Fakultet të Edukimit me shumën prej 5 mijë e 586 euro, furnizim me pajisje të ndryshme laboratorike mjekësore për Fakultetin e Mjekësisë në vlerë prej 19 mijë e 200 euro, si dhe shpallja e tenderit për ndërtimin e kampusit universitar me shumë prej 16 milionë euro.

### \*Bursa për studentë

Nga kategoria subvencione dhe transfere, UGJFA për vitin akademik 2018/19, kishte ndarë bursa për 51 studentë<sup>31</sup>, me shumën prej 800 euro për 10 muaj të vitit akademik e që përbëjnë shumën prej 40 mijë e 800 euro, ndërkohë që për vitin akademik 2019/2020<sup>32</sup>, për 80 studentë<sup>33</sup> janë ndarë bursa me shumën prej 800 euro për 10 muaj të vitit akademik, pra gjithsej janë shpenzuar 64 mijë euro. Të planifikuara për vitin akademik 2020/21 janë 65 mijë euro.

### \*Sigurimi fizik i objekteve

Shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2019 kanë arritur shumën prej 58 mijë e 302 euro, ndërsaq për vitin 2020, UGJFA ka shpenzuar gjithsej 700 mijë euro për sigurimin fizik të objekteve.

### \*Shpenzimet gjyqësore

Sipas UGJFA-së, në vitin 2019 kanë depouar dy ankesa në Gjykatën Themelore të Gjakovës dhe i kanë shpenzuar 85 euro, ndërkohë që kanë sqaruar se gjatë vitit 2019, kanë paguar edhe për një çështje kontestimore për kompensimin e të ardhurave personale, të cilën e kanë trashëguar nga viti akademik 2015-2016, për të cilën kanë shpenzuar gjithsej 2 mijë e 307 euro, si pasojë e aktgjykimit të formës së prerë nga gjykata në fjalë.

### \*Investimet kryesore kapitale

Gjatë vitit 2019, sipas këtij universiteti, investimet kapitale nuk kanë qenë të mundura për shkak të ndërrimit të titullarit të pronave të ish-kazermave ushtarake dhe vendimit të qeverisë për realizimin e projektit të kampusit universitar, ndërkohë që për vitin 2020 kanë filluar këto projekte; Rregullimi dhe renovimi i zyreve në Rektorat

31 Lista e bursistëve të Universitetit të Gjakovës për vitin akademik 2018/19, 2018, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/17498-lista%20e%20bursave.pdf>

32 Vendimi i Këshillit Drejtues të UGJFA-së për ndarjen e bursave për vitin akademik 2019/20, 2019, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1570707522-IMG.pdf>

33 Lista e bursistëve të UGJFA-së për vitin akademik 2019/20, 2019, linku: [https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1573050778-SKM\\_C55819110616550.pdf](https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1573050778-SKM_C55819110616550.pdf)



## UNIVERSITETI I MITROVICËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Mitrovicës (UMIB), ka gjithsej 95 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 29 apo 31% gra, si dhe 19 të angazhuar, prej tyre 2 apo 11% gra.

Universiteti i Mitrovicës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 1 mijë e 660 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 152 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 126 femra dhe 534 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 140 femra dhe 96 meshkuj, pra 259 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 72 femra dhe 80 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 18 femra dhe 29 meshkuj, pra 47 të diplomuar.

Raporti student-mësimdhënës del të jetë 14:1.

### Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Mitrovicës, janë ndarë gjithsej 4 milionë e 788 mijë e 969 euro vetëm për vitin 2019, ndërkaq për vitin 2020, janë ndarë 3 milionë e 886 mijë e 978 euro.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2019, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 2 milionë e 757 mijë e 430 euro apo 57%, të parapara për 147 të punësuar, ndërsa për vitin 2020 është rritur për mbi 100 mijë euro, meqenëse janë ndarë 2 milionë e 879 mijë e 706 euro për këtë kategori, e cila ka 199 të punësuar.

Për mallra dhe shërbime, UMIB-it i ishin ndarë 966 mijë e 339 euro për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2020, kjo shumë është zbritur në 316 mijë e 339 euro. Për shpenzime komunale gjatë vitit 2019, ishin paraparë 215 mijë e 200 euro, ndërkaq për vitin 2020, kjo shumë ka rënë në 134 mijë e 174 euro. Shuma e ndarë për subvencione dhe transfere në UMIB, përgjatë viteve 2019 dhe 2020 nuk ka ndryshuar, pra janë ndarë nga 100 mijë euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dalton mes këtyre viteve për mbi 300 mijë euro, meqenëse për vitin 2019, janë ndarë gjithsej 850 mijë euro, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 456 mijë e 759 euro.



## LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E MITROVICËS 2019 DHE 2020

Shumës së përgjithshme të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, UMIB i kishte shtuar edhe 114 mijë e 661 euro nga të hyrat vetanake, sipas raportit Buxheti për vitin 2019, i publikuar nga universiteti në fjalë<sup>34</sup>.

Në pasqyrën e pagës mujore, rektori i këtij universiteti ka marrë 2 mijë e 731 euro për muaj, ndërsa tre prorektorët, nga shuma totale prej 6 mijë e 595 eurove, kanë marrë nga 2 mijë e 198 euro.

Për profesorë të rregullt në këtë universitet, janë ndarë gjithsej 32 mijë e 375 euro nga buxheti i shtetit, pra këta profesorë kanë marrë nga 2 mijë e 23 euro.

Ndërsa dhjetë profesorë të Asocuar, i kanë kushtuar buxhetit të vendit 18 mijë e 575 euro, konkretisht nga 1 mijë e 857 euro.

Për 30 profesorë Asistent, janë ndarë 41 mijë e 133 mijë euro, nga 1 mijë e 371 euro për profesor.

48 asistentë, i kanë kushtuar buxhetit të vendit 41 mijë e 132 euro, nga 857 euro.

Shpenzimet për studentë në vitin 2020 janë 2,963 Euro për kokë studentit.

Pagat dhe mëditjet	2019	2,757,430.00	57.58%
	2020	2,879,706.00	74.09%
Mallrat dhe shërbimet	2019	866,339.00	18.09%
	2020	316,339.00	8.14%
Shpenzimet komunale	2019	215,200.00	4.49%
	2020	134,174.00	3.45%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000.00	2.09%
	2020	100,000.00	2.57%
Shpenzimet kapitale	2019	850,000.00	17.75%
	2020	456,759.00	11.75%
<b>Total Shpenzimet</b>	2019	<b>4,788,969</b>	<b>100%</b>
	2020	<b>3,886,978</b>	

<sup>34</sup> Raporti i buxhetit të Universitetit të Mitrovicës, 2019, linku: <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2020/01/buxheti-2019.pdf>

## Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Mitrovicës janë të rregulluara përmes Rregullores për të ardhura personale në Universitetin e Mitrovicës, e miratuar më 06.11.2015.<sup>35</sup>

Neni 5 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1429.54 euro
Profesorët e asocuar	 6	1283.34 euro
Profesorët asistent	 6	1137.14 euro
Profesorët e shkollave të larta	 6	1137.14 euro
Ligjëruesit	 6	990.00 euro
Lektorët	 10	844.73 euro
Asistentët	 10	772.50 euro
Asistent i ri	 10	698.75 euro

**Tabela 1.** Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Mitrovicës, kompensohet sipas kësaj tablele:

<sup>35</sup> Rregullorja për të ardhura personale në Universitetin e Mitrovicës. 06.11.2015. Link: <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2019/09/Tekstin-e-spastruar-te-Rregullores-per-te-ardhurat-personale-ne-UMIB.pdf>



<b>Pozita</b>	<b>Shtesa</b>
Rektor	500 euro
Prorektor	450 euro
Dekan	350 euro
Prodekan	250 euro

**Tabela 2.** Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës

Personeli akademik në Universitet të Mitrovicës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 5 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

<b>Titulli</b>	<b>Shtesa</b>
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	25 euro
Ligjërues, lektor, asistent	13 euro

**Tabela 3.** Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

<b>Komisioni</b>	<b>BA</b>	<b>MA</b>	<b>PHD</b>
Mentori	20 euro	250 euro	1000 euro
Kryetari i komisionit	n/a	90 euro	300 euro
Anëtar i komisionit	10 euro	80 euro	250 euro

**Tabela 4.** Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

2018

2019

		2018	2019
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1745 €	1915 €
	Rektorati	2398 €	1964 €
	Dekanët	1986 €	2024 €
	Prodekanët	1710 €	1664 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	652 €	869 €
	Rektorati	1079 €	645 €
	Dekanët	812 €	692 €
	Prodekanët	609 €	496 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1505 € 2250 €	1684 € 2476 €
	Rektorati	2105 € 2822 €	1721 € 2261 €
	Dekanët	1647 € 2343 €	1778 € 2285 €
	Prodekanët	1530 € 1922 €	1140 € 1849 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	506 € 890 €	547 € 1193 €
	Rektorati	822 € 1685 €	292 € 832 €
	Dekanët	401 € 1167 €	349 € 863 €
	Prodekanët	321 € 785 €	3 € 980 €

## Analiza e të dhënave nga deklarimet e pasurisë

Në analizën e deklarimeve të pasurisë për Universitetin e Mitrovicës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1915 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 869 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 45% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të të ardhurave mesatare krahasuar me deklarimet e pasurisë për vitin 2018, ku të ardhurat mesatare ishin 1745 Euro në muaj dhe shtesat 652 Euro.

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 1964 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 645 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 33% të rrogës së tyre mujore. Krahasuar me vitin 2018, shumica mesatare dhe shtesa ka rënë meqenëse të ardhurat e tyre mesatare ishin 2398 Euro në muaj, ndërsa shtesat 1079 Euro.



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë për vitin 2019, me shumatat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuar për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 5.**

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 2024 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 692 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë 34% të rrogës së tyre mujore. Krahasuar me deklaratimet e pasurisë për vitin 2018 të ardhurat mesatare 1986 Euro janë të ngjashme, ndërkohë që shtesat që ishin 812 Euro janë zvogëluar.

